# AMC – ACTION FOR MOTHERS AND CHILDREN

**Financial Statements**
**For the year ended as at December 31, 2021**

## MANAGEMENT LETTER

23 March 2022

**MANAGEMENT LETTER**

**To: Management of Action for Mothers and Children (AMC)**

We have audited the financial statements of the Action for Mothers and Children (the organisation) for the year ended December 31, 2021. In planning and performing our audit, we considered its internal control over financial reporting as basis for designing our auditing procedures, obtained an understanding of the design effectiveness of internal controls, determined whether internal controls have been placed in operation, assesses control risk, and performed tests of the project's internal controls for the purpose of expressing our opinion on the financial report, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the organization's internal control over financial reporting.

Findings and recommendation addressed through management letter to 'AMC' for the period ended as at December 31, 2020 were implemented during 2021. No findings arises for the period 1 January 2021 to 31 December 2021.

This report is intended solely for the information and use of the AMC – Action for Mothers and Children management and is not intended to be and should not be used by anyone other than these specified parties.

bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

Yours sincerely

Lulzim Zeka
Statutory Auditor

Baker Tilly Kosovo

MANAGEMENT LETTER
ACTION FOR MOTHERS AND CHIDREN
For the year ended as at December 31, 2021

1. **Finding (C)**

In the QB accounting system the names of the respective donors are not written in relation to donor incomes.

**1.1. Impact**

In cases where the exact and detailed name of the donor is not described in the system, there is a possibility of making a mistake in reclassifying or recognizing the income from donations.

**1.2. Recommendation**

We recommend that the "name" section in the accounting system be completed according to adequate descriptions whether for donations received or expenses.

| |
|---|
| **Actual Status: Recommendations implemented. No finding arises for the year ended as at 31 December 2021.** |

Priority:
- A Urgent action required: High business risk to be brought to the attention of AMC management and to be addressed as matter of urgency.
- B Financial statements, accounting procedures or control weakness exists with medium risk of financial loss or incorrect accounting treatment being applied.
- C Financial statements, accounting procedures or control weakness exists with low risk of financial loss or incorrect accounting treatment being applied

**AKCIONI PËR NËNA DHE FËMIJË (ANF)**
Prishtinë, Kosovë

**PASQYRAT FINANCIARE**
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021

dhe
**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

Përmbajtja:

**RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR** ..... 2
**PASQYRA E POZITËS FINANCIARE** ..... 4
**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE** ..... 5
**PASQYRA E RRJEDHËs SË PARASË TË GATSHME** ..... 6
1. Hyrje ..... 7
2. Politikat e kontabilitetit ..... 7
3. Paraja dhe ekuivalentët e saj ..... 8
4. Llogaritë e arkëtueshme ..... 9
5. Llogaritë e pagueshme ..... 9
6. Të hyrat e shtyra ..... 9
7. Të hyrat nga grantet ..... 10
8. Shpenzimet e personelit ..... 11
9. Shpenzimet tjera operative dhe administrative ..... 11
10. Shpenzimet sipas projekteve ..... 12
11. Kontigjencat dhe zotimet ..... 12
12. Ngjarjet pasuese ..... 12

bakertilly

Bekim Fehmiu, 110 Icon Tower, Kati XV, Prishtina, Kosovo

T: +383 (0)38 707 071

info@bakertillyks.com
www.bakertillyks.com

**RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR**

Për: Menaxhmentin e Akcioni për Nëna dhe Fëmijë (ANF)

**Opinioni**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Akcioni për Nëna dhe Fëmijë" (Organizata), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2021, Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe psaqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të organizatës 'Akcioni për Nëna dhe Fëmijë' për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, siç përcaktohet në Shënimin 2. dhe kërkesave të Ligjit Nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

**Baza për opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrolle të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetiti bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

**Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

bakertilly

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka
Auditor Ligjor

bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo
16 mars 2022

Baker Tilly Kosovo trading as Baker Tilly is a member of the global network of Baker Tilly International Limited, the members of which are separate and independent legal enti

## AKCIONI PËR NËNA DHE FËMIJË (ANF)

**PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**

Me 31 dhjetor 2021

*(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)*

| | Shënimet | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| **PASURIA** | | | |
| **Pasuria qarkulluese** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj | 3 | 378,433 | 301,126 |
| Llogaritë e arkëtueshme | 4 | 37,950 | 24,205 |
| **Gjithsej pasuria qarkulluese** | | 416,382 | 325,330 |
| **GJITHSEJ PASURIA** | | **416,382** | **325,330** |
| **BALANCI FONDEVE** | | | |
| Balanci i fondeve në fillim të vitit | | - | - |
| Teprica / (mungesa) e fondeve për vitin | | - | - |
| **Gjithsej balance i fondeve** | | **-** | **-** |
| **Detyrimet qarkulluese** | | | |
| Llogaritë e pagueshme | 5 | 11,366 | 3,035 |
| Të hyrat e shtyra | 6 | 405,016 | 322,295 |
| **Gjithsej detyrimet qarkulluese** | | **416,382** | **325,330** |
| **GJITHSEJ BALANCI I FONDEVE DHE DETYRIMET** | | **416,382** | **325,330** |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 15 shkurt 2022 në emër të Menaxhmentit të organizatës:

Drejtor Ekzekutiv
**Vlorian Molliqaj**

Zyrtare e lartë financiare
**Ariana Hoxha Selmani**

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

## AKCIONI PËR NËNA DHE FËMIJË (ANF)
### PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021
*(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)*

| Për vitin që përfundoi | Shënimet | Më 31 dhjetor 2021 | Më 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat nga grantet | 7 | 340,787 | 362,541 |
| **Gjithsej të hyrat nga grantet** | | **340,787** | **362,541** |
| **Shpenzimet** | | | |
| Shpenzimet e personelit | 8 | 161,878 | 161,906 |
| Shpenzimet operative dhe administrative | 9 | 178,909 | 200,635 |
| **Gjithsej shpenzimet** | | **340,787** | **362,541** |
| **Fitimi / (humbja) për vitin** | | **-** | **-** |

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

## AKCIONI PËR NËNA DHE FËMIJË (ANF)
**PASQYRA E RRJEDHËs SË PARASË TË GATSHME**
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021
*(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)*

| Për vitin e përfunduar | Shënimi | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| **Aktivitetet operative** | | | |
| Fitimi / (humbja) i/e vitit | | - | - |
| **Korigjimet për zërat jo-monatrë** | | | |
| Shpenzimi i zhvlerësimit | | - | - |
| Ndryshimet në parapagime | 4 | (13,745) | (24,205) |
| Ndryshimet në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera | 5 | 8,331 | (3,761) |
| Ndryshimet në të hyrat e shtyra | 6 | 82,721 | 84,442 |
| **Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative** | | **77,307** | **56,477** |
| **Aktivitetet investive** | | | |
| Blerja e pronës, pajisjes dhe impianteve | | | |
| **Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet investive** | | **-** | **-** |
| **Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë nga aktivitetet** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit | 3 | 301,126 | 244,649 |
| **Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit** | | **378,433** | **301,126** |

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME

### 1. Hyrje

Aksioni për Nënat dhe Fëmijët (Organizata) është një organizatë jofitimprurëse e themeluar më 21 maj 2013 në përputhje me Ligjin nr. 06/L-057 për Lirinë e Shoqatës në Organizatat Jo-Qeveritare. Aksioni për Nënat dhe Fëmijët është një fondacion jo-fitimprurës, jo-qeveritar, jo-sektarian, humanitar që zhvillon programe shëndetësore në Gjinekologji/Klinika Obstetrike (që kujdesen për nënat) Njësitë e Kujdesit Intensiv të Neonatologjisë (që kujdesen për bazën para-maturimit) dhe Klinikat Pediatrike (që kujdesen për fëmijët që vuajnë nga Leukemia, sëmundjet e zemrës, astma dhe sëmundje të tjera) në Republikën e Kosovës.

**Për të përmbushur misionin e tij, fondacioni:**

- Avokon me forcë për kujdes më të mirë shëndetësor për gratë dhe fëmijët në të gjithë Republikën e Kosovës
- Studion problemet e tyre shëndetësore dhe sistemet e kujdesit shëndetësor që adresojnë këto probleme
- Zhvillon programe dhe projekte që do të ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve
- Akordon përparësi të lartë atyre aktiviteteve që do të zvogëlojnë shkallën relativisht të lartë të vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave në Kosovë;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë dhe administratorë të tjerë që kanë qëllime dhe objektiva të ngjashëm.

### 2. Politikat e kontabilitetit

#### 2.1. Përmbledhje e politikave kontabël

Organizata mban regjistrat e saj të kontabilitetit në bazën e modifikuar të parave të gatshme të kontabilitetit. Prandaj, të ardhurat regjistrohen kur paratë merren dhe shpenzimet regjistrohen kur paguhen. Modifikimet në bazën e parave të gatshme të kontabilitetit kanë të bëjnë me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të cilat njihen në fund të periudhës raportuese.

#### 2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë së kosts historike në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Kosovë.

#### 2.3. Valuta funksionale dhe transaksionet në valuta të huaja

Akcioni për Nëna dhe Fëmijë organizata i regjistron transaksionet në Euro. Të gjitha shumat e raportuara në Pasqyrën e pozitës financiare dhe në ndryshimet në asetet neto janë raportuar në Euro. Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen sipas normave të këmbimit në fuqi me datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe detyrimet monetare në valuta të huaja janë konvertuar sipas normës së këmbimit në datën e Bilancit të Gjendjes. Fitimi apo humbja si rezultat i këmbimit është regjistruar në Pasqyrën e të Ardhurave.

#### 2.4. Tatimi në të ardhura

Organizata është një organizatë joqeveritare (OJQ), donacionet e të cilave janë pranuar në vitin raportues janë përdorur për qëllime humanitare. Sipas ligjit nr. 06 / L-105 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, OJQ-të, të ardhurat totale të të cilave përdoren për qëllimet e tyre të përfitimit publik, përjashtohen nga taksat.

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME (vazhdim)

### 2.5. Prona, impiantet dhe pajisjet
Organizata nuk përdor politikë mbi kapitalizimin pasurive joqarkulluese por i debiton përmes pasqyrës së të ardhurave gjiithëpërfshirëse (shpenzimeve) vjetore. Organizata asetet jo-qarkulluese i njeh shpenzim të vitit në momentin e ndodhjes, por gjithashtu mban një listë të aseteve specifike sipas donatorëve.

### 2.6. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në dorë dhe para të depozituara në bankë.

### 2.7. Transaksionet në valutë të huaj
Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja rikthehen me kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese. Diferencat në valutë të huaj që vijnë nga ri-përkthimi njihen në fitim ose humbje.

### 2.8. Të hyrat
Të hyrat e organizatës paraqesin donacionet e pranuara nga donatorët. Të hyrat njihen kur fitohen ne vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin ne vend se kur paguhen. Të hyrat njihen në nivelin e shpenzimeve të ndodhura dhe trajtohen sipas SNK 20. Pjesa mbetur prezantohet si e hyrë e shtyrë apo si fonde të mbajtura në dispozicion për shfrytëzim në të ardhmen.

### 2.9. Shpenzimet
Organizata njeh shpenzimet në momentin e ndodhjes. Shpenzimet regjistrohen sipas bazës akruale. Shpenzimet e organizatës përbëhen nga shpenzimet e personelit, shpenzimet operative dhe adminsitrative, programore dhe tjera të përgjithshme.

### 2.10. Llogaritë e pagueshme
Kontributi i pensionit, taksat e pagave dhe detyrimet e tjera të përllogaritura, janë hedhur në pasqyrat financiare si llogari të pagueshme.

### 2.11. Të hyrat e shtyra
Të hyrat e shtyra janë një e ardhur/donacion për të cilin paratë e gatshme janë mbledhur nga organizata, por ende nuk janë shpenzuar. Si pasojë kjo përgjegjësi ndodh kur 'ANF' merr parapagim për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen.

### 2.12. Deficiti i të ardhurave mbi shpenzimet
Bilanci negativ (deficiti) është rezultat i dhurimeve dhe kostove të implementuara të projektit deri në fund të vitit.

### 2.13. Përfitimet e punonjësve
Organizata jep kontribute për përfitimet e punonjësve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Kontributet shpenzohen kur ndodhin.

## 3. Paraja dhe ekuivalentët e saj

| | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Paraja në bankë | 378,068 | 300,774 |
| Paraja në arkë | 364 | 352 |
| **Gjithsej** | **378,433** | **301,126** |

## 4. Llogaritë e arkëtueshme

| | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Parapagimi i qirasë | 1,099 | 1,099 |
| Llogaritë e arkëtueshme (Granti nga HMC) | 36,851 | 23,106 |
| **Gjithsej** | **37,950** | **24,205** |

Granti i arkëtueshëm më 31 dhjetor 2020 në shumën 23,106 Euro ka të bëj me fondet e arkëtueshme që janë fituar por nuk janë marrë nga donatori Dartmouth - Hitchcoock Medical Center. Këto fonde u pranuan nga organizata në janar të vitit 2021. Më 31 dhjetor 2021 fondet e arketueshme nga Dartmouth – Hitchcook Medical Center janë në shumën prej 36,851 Euro. Deri në mars të vitit 2022 u arkëtuan 28,394 Euro ndërsa pjesa tjetër mbetet të arkëtohet gjatë vitit 2022.

## 5. Llogaritë e pagueshme

| | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve | 10,966 | - |
| Detyrimet tjera akruale | - | 177 |
| Kontributi pensional i pagueshëm | - | 1,649 |
| Tatimi i mbajtur në të ardhurat personale | - | 1,184 |
| Qiraja e pagueshme | 400 | - |
| Tatimi në qira (WR) | - | 25 |
| **Gjithsej** | **11,366** | **3,035** |

## 6. Të hyrat e shtyra

| | Me 31 dhjetor 2020 | Fondet e pranuara në vitin 2021 | Shpenzimet për vitin 2021 | Më 31 dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Overhead | 203,330 | 59,131 | 47,535 | 214,926 |
| GC_1000 Horizon | 76,252 | 64,550 | 47,548 | 93,253 |
| UNICEF | - | 57,495 | 35,320 | 22,175 |
| UNFPA | 8,945 | 40,361 | 49,307 | - |
| Save the children | 159 | 41,186 | 41,345 | - |
| GGP | - | 54,370 | 54,370 | - |
| KCSF | - | 6,026 | 1,629 | 4,397 |
| EBRD Community Initiative | - | 50,000 | 4,906 | 45,094 |
| Bulgarian Embassy | - | 6,405 | - | 6,405 |
| Precedence Grant | - | 4,000 | - | 4,000 |
| Solidar Suisse | 1,000 | - | 1,000 | - |
| RBKO | 6,316 | - | 6,316 | - |
| Teshavesha | 12,692 | 15,265 | 14,153 | 13,803 |
| CFLI | 4,988 | 9,735 | 13,761 | 963 |
| CKC | 104 | 9,896 | 10,000 | - |
| Johns Hopkins Uni. | 4,641 | 5,089 | 9,730 | - |
| CITY / London University | 1,962 | - | 1,962 | - |
| Australian DAP | 1,906 | - | 1,906 | - |
| **Total** | **322,295** | **423,508** | **340,787** | **405,016** |

## 6. Të hyrat e shtyra (vazhdim)

Të hyrat e shtyra në fund të vitit përfaqësojnë fondet e mbetura nga fondet e donatorëve, fonde të cilat do të përdoren gjatë implementimit të projekteve në të ardhmen. Bilanci i të hyrave të pa fituara prezantohet si mësipër.

## 7. Të hyrat nga grantet

| Për vitin që përfundon | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Overhead | 59,131 | 65,677 |
| GC_1000 | 64,550 | 112,395 |
| UNICEF | 57,495 | 102,438 |
| UNFPA | 40,361 | 49,318 |
| Save the children | 41,186 | 32,645 |
| GGP | 54,370 | - |
| KCSF | 6,026 | - |
| EBRD | 50,000 | - |
| Bulgarian Embassy | 6,405 | - |
| Precedence Grant | 4,000 | - |
| Solidar Suisse | - | 7,441 |
| RBKO | - | 18,600 |
| Teshavesha - Program | 15,265 | 11,592 |
| UNDP | - | 5,000 |
| CFLI | 9,735 | 6,634 |
| LDS | - | 10,015 |
| CKC | 9,896 | - |
| Johns Hopkins Uni. | 5,089 | - |
| Bucaj Shpk | - | 10,000 |
| CITY / London University | - | 7,227 |
| Council de Europe (COE) | - | 4,000 |
| Australian DAP | - | 4,001 |
| **Total Income** | **423,508** | **446,983** |
| | | |
| Të hyrat e shtyra në villim të vitit | 322,295 | 237,853 |
| Të hyrat e shtyra në fund të vitit | (405,016) | (322,295) |
| | | |
| **Të hyrat e njohura nga grantet** | **340,787** | **362,541** |

## 8. Shpenzimet e personelit

| | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Pagat Bruto (personeli i ANF) | 119,647 | 112,193 |
| Kontributet pensionale 5% | 5,982 | 5,905 |
| **Nën Totali (I)** | **125,629** | **118,098** |
| Pagat Bruto (ekspertë afatshkurtë) | 34,523 | 41,617 |
| Kontributet pensionale 5% | 1,726 | 2,190 |
| **Nën Totali (II)** | **36,249** | **43,808** |
| **Gjithsej (I + II)** | **161,878** | **161,906** |

Shpenzimet e pagave të personelit kryesor për vitin 2021 janë në shumën prej 125,629 Euro (2020; 118,098 Euro). Shpenzimet e tjera të pagave për vitin 2021 në vlerë prej 36,246 Euro (2020; 43,808 Euro), paraqesin shpenzimet e personelit afatshkurtër të angazhuar gjatë implementimit të projekteve të zhvilluara nga organizata.

## 9. Shpenzimet tjera operative dhe administrative

| **Për vitin e përfunduar** | **Me 31 dhjetor 2021** | **Me 31 dhjetor 2020** |
|---|---|---|
| Shpenzimet e trajnimit | 5,098 | 25,666 |
| Shpenzimet për pajisje mjekësore | 72,777 | 79,872 |
| Shpenzimet e marketingut | 2,220 | 5,805 |
| Shpenzimet për shërbimet e kontraktuara | 7,648 | 5,687 |
| Shpenzimet për mbledhjen e fondeve | 1,073 | 211 |
| Shpenzimet e qirasë dhe mirëmbajtjes | 17,885 | 13,073 |
| Shpenzimet e transportit | 2,619 | 5,254 |
| Shpenzimet për grantistët | - | 10,421 |
| Shpenzimet tjera | 3,633 | 4,458 |
| Shpenzimet e akomodimit | 2,205 | 5,159 |
| Shpenzimet për furnizimin e zyrës | 5,291 | 5,489 |
| Shpenzime profesionale dhe kontabilitet | 2,650 | 4,300 |
| Shpenzimet bankare | 470 | 897 |
| Shpenzimet për komunali | 5,093 | 2,718 |
| Shpenzimet për publikime kërkimore | - | 200 |
| Shpenzimet e telekomunikimit | 5,612 | 7,235 |
| Shpenzimet representative dhe takimeve | 617 | 602 |
| Shpenzimet për fushatën e rritjes së ndërgjegjësimit | 11,778 | 20,775 |
| Shpenzimet për diskutimet e hapura | 2,580 | 873 |
| Shpenzimet për workshop | 1,207 | 1,938 |
| Shpenzimet për printim | 9,333 | - |
| Shpenzimet për pajisjet tjera lidhur me projekte | 19,121 | - |
| **Total** | **178,909** | **200,635** |

**10. Shpenzimet sipas projekteve**

| Për vitin e përfunduar | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Overhead | 59,737 | 45,025 |
| GC_1000 | 47,548 | 36,143 |
| UNICEF | 35,320 | 102,438 |
| UNFPA | 38,244 | 52,773 |
| Save the children | 41,205 | 32,486 |
| GGP | 54,370 | - |
| KCSF | 1,629 | - |
| Solidar Suisse | - | 6,441 |
| RBKO | 6,316 | 20,289 |
| Teshavesha - Program | 14,153 | 20,819 |
| UNDP | - | 5,000 |
| CFLI | 13,761 | 1,645 |
| LDS | - | 10,015 |
| CKC | 10,000 | 4,845 |
| Johns Hopkins Uni. | 9,730 | - |
| Bucaj Shpk | - | 10,000 |
| CITY / London University | 1,962 | 5,265 |
| Council de Europe (COE) | - | 4,000 |
| Australian DAP | 1,906 | 2,095 |
| WHRC | - | 3,261 |
| EBRD CI | 4,906 | - |
| **Total** | **340,787** | **362,541** |

**11. Kontigjencat dhe zotimet**

***Çështjet ligjore***

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, kompania nuk ka qenë e involvuar në ndonjë cështje ligjore, përveq atyre që ishin normale gjatë veprimtarisë së saj.

**12. Ngjarjet pasuese**

*Ngjarjet e jashtëzakonshme*
Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat kërkojnë rregullime materiale të vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, menaxhmenti pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e pasurive të patrupëzuara, pronës dhe pajisjeve, pasurive me të drejtë përdorimi, llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme tjera, huamarrjeve, llogarive të pagueshme dhe të pagueshme tjera dhe vlerës së tyre bartëse mund të kërkoj korrigjim.
Duke marrë parasysh që pandemia Covid-19 ka ndikuar globalisht në proceset e punës, zbatimin e projekteve, afatet kohore dhe parashikimet financiare të organizatave, organizata nuk ka pasur probleme me fondet nga donatorët dhe arritjen e objektivave të projekteve dhe organizatës.
Sidoqoftë, në këtë fazë menaxhmenti nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet rrjedhin dita ditës. Ndikimi afatgjatë gjithashtu mund të ketë një ndikim në të ardhurat, flukset e parave dhe financimin. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, organizata vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë bazën për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas parimit të vazhdimësisë.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.